



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.100 Datë 04.07.2017

MBI

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONCENSIONARE” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, 41 pika 1, gërma “a” dhe pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 35 pikat 1 dhe 2, 38 pika 2 dhe neni 58 Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 7 dhe 10, pika 2 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17 .06.2017; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “LUÇENTE KONCENSIONARE” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “LUÇENTE KONCENSIONARE”sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Bordi i ERE me vendimin nr.186, datë 23.11.2016, është shprehur për mosfillimin e procedurave të licencimit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “LUÇENTE KONCENSIONARE” sh.p.k për shkak të mos plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.
- Me shkresën nr. 61 Prot, datë 23.04.2017, subjekti ka paraqitur kërkesën në ERE, për vazhdimin e procedurës në tejkalim të afatit 1 mujor parashikuar në nenin 10, pika 7 e rregullores.
- Me shkresën nr. 334 Prot., datë 08.05.2017, ERE ka njoftuar subjektin për të aplikuar sërish, për shkak të tejkalimit të afateve brenda të cilave mund të plotësohet dokumentacioni i munguar pas rrëzimit të kërkesës për fillimin e procedurave të miratimit të kërkesës.

- Kërkesa me nr. 84 Prot., datë 17.05.2017, e paraqitur në ERE, për vazhdimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “LUÇENTE KONCENSIONARE”sh.p.k, është e nënshkruar nga një person i pa autorizuar, për të cilin nuk është depozituar prokurë përfaqësimi, personi është i pa identifikuar, (i mungojnë gjeneralitetet), nuk disponon vulën e subjektit dhe marrdhëniet në raport me subjektin janë të pa përcaktuara, nuk rezulton të jetë administrator i shoqërisë ose përfaqësues, referuar ekstratit të QKR.
- Kërkesa e paraqitur nuk vjen në pajtim me nenet 35 pikat 1 dhe 2 , 38 pika 2 dhe 58 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Prcedurave Administrative”, si dhe nenit 7 pika 1, pika 2 gërma “a” dhe “b” dhe pika 3 gërma “a” dhe “b”, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet per Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Dokumentacioni i paraqitur më poshtë, nuk i plotëson kushtet e një aplikimi, në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullorje në nenin 10 të saj, për sa vijon:
 - Neni 9, pika 3 gërma ”c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) e pa plotësuar.
 - Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC); e pa plotësuar.
 - Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin) e pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “LUÇENTE KONCENSIONARE” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI